

PYETJET E HISTORISE SE ARTIT

Departamenti i Arteve të Aplikuara

Pyetjet janë të ndara në numra rendor dhe çdo numër përmban tre nënpyetje:

a - Nga historia e artit botëror

b – Nga historia e artit shqiptar

c - Nga specialiteti i zgjedhur

Pyetjet shërbejnë për njërën nga fazat e konkursit të pranimit të studentëve në Universitetin e Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura. Krahas konkurimit praktik në pikturë, skulpturë dhe vizatim, studenti testohet edhe teorikisht për njohuritë e tij rreth Historisë së Artit botëror, Historisë së Artit Shqiptar me specifikisht mbi specialitetin e përzgjedhur.

Pyetjet shërbejnë si një orientim fillestar në bashkëbisedim. Anëtarët e komisionit kanë të drejtë të bëjnë dhe pyetje shtesë kur ata e shohin të nevojshme.

Secili student tërheq tezën me pyetjet dhe përgjigjet në prani të komisionit. Studenti ka të drejtë të tërheqë pyetjet deri në dy herë.

...

PYETJET PËR PROGRAMIN TEKSTIL DHE MODË:

Teza 1

- a. Flisni për *Artin klasik Grek*. Për çfarë periudhe të artit po flasim dhe çfarë karakteristikash paraqet ajo?
- b. Flisni për karakteristikat e *Artit* në Shqipëri në gjysmën e dytë të shekullit XX. Përmendni disa piktorë shqiptarë të kësaj periudhe.
- c. Përmendni një stilist bashkohor që pëlqeni. Flisni për karakteristikat që e bëjnë punët e tij të dallueshme nga stilistët e tjerë.

Teza 2

- a. Flisni për piktorin Van Gogh, nga ishte ai dhe për çfarë dallohet krijimtaria e tij?
- b. Cilët janë fotografët *Marubi* dhe cila është vlera e punës së tyre.
- c. Flisni për *Coco Chanel*, stili, veshjeve të saj dhe risitë që solli ajo në modën e shekullit të XX-të.

Teza 3

- a. Flisni për Leonardo da Vincin dhe tiparet e veprës së tij. Përmendni dhe komentoni dy vepra nga ky artist.
- b. Flisni për *Amfiteatrin e Durrësit*. Periudha e ndërtimit dhe historia e tij.
- c. Çfarë dini për *Veshja popullore shqiptare*. Flisni për karakteristikat e një veshje popullore të një krahine që njihni.

Teza 4

- a. Flisni për artistin italian *Mikelanxhelo*. Kur jetoi ai dhe për cilat vepra është i famshëm. Flisni më gjatë për një të një prej tyre.
- b. Çfarë dini për veshjet popullore shqiptare. A u bënë ato burim frymëzimi për krijimtarinë artistike të artistëve evropian dhe kur?
- c. Cila është sfilata e fundit që keni parë. Komentoni atë dhe vlerat që ajo përcillte.

Teza 5

- a. Çfarë është *arti Barok*. Periudha kohore dhe tipare të këtij stili. Përmendni dhe komentoni dy vepra nga kjo periudhe.
- b. Çfarë janë “*Kodikët*”. Flisni më gjatë për “*Kodikun e Purpurt të Beratit*” dhe rëndësinë e tij.
- c. Flisni mbi një nga *shtëpitë më të vjetra të modës europiane*. Çfarë ju pëlqen më shumë tek ajo.

Teza 6

- a. Cila është kohëzgjatja dhe tiparet në artin e *Rilindjes Italiane*. Përmendni dhe komentoni disa personalitete të kësaj periudhe.
- b. Kur u vendos metoda e “*Realizmi Socialist*” në Shqipëri. Cilat ishin tiparet kryesore të kësaj rryme. Komentoni një vepër tipike të Realizmit Socialist Shqiptar.
- b. Flisni për artin e modës sot në Shqipëri. Përmendni disa stilistë të famshëm që ju njihni.

Teza 7

- a. Flisni për Ekspresionizmin Abstrakt. Tiparet, artistë dhe vepra të këtij stili.
- b. Flisni mbi pikturën shqiptare në periudhën e viteve 30. Flisni më gjatë për një nga autorët e kësaj periudhe.
- c. Çfarë është Xhubleta dhe cilës krahinë i takon ajo?

Teza 8

- a. Çfarë kuptoni me termin Impresionizëm. Flisni për rëndësinë e kësaj periudhe artistike dhe për disa nga protagonistët e saj .
- b. Flisni mbi jetën dhe veprën e *Kol Idromenos*. Analizoni e komentoni pikturën e tij “Motra Tone”.
- c. Përmendni dhe komentoni dy vepra artistike (piktura apo skulptura), ku veshja është element i rëndësishëm në mesazhin e paraqitjes.

Teza 9

- a. Citoni disa rrymat, apo *stile artistike të shek. XX*. Shpjegoni më gjerë njerën prej tyre si dhe dy vepra nga rryma e zgjedhur.
- b. Çfarë dini rreth piktorit Onufri? Ku u zhvillua vepra e tij dhe çfarë risish kishte ajo për kohën?
- c. Përmendni disa fotografë mode dhe shpjegoni funksionin e punës së tyre.

Teza 10

- a. *Flisni për piktorin e njohur Rembrand.* Komentoni një vepër nga ky artist.
- b. Citoni disa vepra të skulptorit *Odhise Paskali* dhe analizoni njerën prej tyre.
- c. Përmendni dhe komentoni dy revista të rëndësishme mode. Çfarë funksioni kanë ato për industrinë e modës.

Teza 11

- a. *Flisni për piktorin e njohur Velasques.* Kur jetoi ai dhe cila është vepra e tij më e rëndësishme.
- b. Citoni disa vepra të piktorit Guri Madhi dhe analizoni njerën prej tyre.
- c. Flisni për stilistin Giorgio Armani dhe për çfarë dallohet stili i tij?

Teza 12

- a. *Flisni për piktorin e njohur Caravaggio.* Komentoni një vepër nga ky artist dhe për çfarë ishte i famshëm ai?
- b. Kush është piktori Sali Shijaku, flisni për një vepër të tij dhe kohën kur jetoi.
- c. Flisni për stilistin Karl Langerfeld dhe për çfarë dallohet stili i tij?

Teza 13

- a. *Flisni për piktorin e njohur Pablo Picasso.* Komentoni një vepër nga ky artist.
- b. Citoni disa vepra të piktorit Vangjush Mio dhe analizoni njerën prej tyre.
- c. Flisni për stilistët Dolce & Gabbana dhe për çfarë dallohet stili i tyre?.

Teza 14

- a. *Flisni për skulptorin e njohur Auguste Rodin. Komentoni një vepër nga ky artist.*
- b. *Citoni disa vepra të skulptorit Kristaq Rama dhe analizoni njerën prej tyre.*
- c. *Flisni për stilistin Gianni Versace dhe për çfarë dallohet stili i tij?*

Teza 15

- a. *Flisni për piktorin e njohur Salvador Dali. Komentoni një vepër nga ky artist.*
- b. *Flisni për skulptorin Thoma Thomai dhe analizoni njerën prej tyre.*
- c. *Flisni për Shtëpinë e Modës “Gucci” dhe për çfarë dallohet stili i tij?.*

Bibliografi

- Ernst H. Gombrich, *Historia e Artit*, (1996).
- Ermir Hoxha, *Historia e Artit Shqiptar 1858- 2000*, (2019)
- Rozela Dhimgjini, *Momente të Historisë së Artit nga Rilindja deri në shek. XX*, (2016).
- **Internet:** List of art movements.

PYETJET PËR PROGRAMIN MULTIMEDIA:

Teza 1

- a. Flisni për *Artin antik Grek* dhe për disa nga periudhat që e përbëjnë atë. Ndaloni më gjatë në një të njërën prej tyre.**
- b. Flisni për piktorin *Abdurrahim Buza* dhe për tiparet e krijimtarisë së tij.**
- c. Çfarë është Video-Art dhe kur lindi ai. Flisni për një artist shqiptar që punon në mediumin e videos.**

Teza 2

- a. Flisni për Kubizmin. Kur lindi kjo rrymë artistike dhe cilët ishin protagonistët e saj?**
- b. Përmendni disa artistë bashkohorë shqiptar. Flisni më gjatë për njërin prej tyre.**
- c. Çfarë kuptoni me "*Art Konceptual*". Përmendni disa shembuj, ku punohet me këtë medium artistik.**

Teza 3

- a. Flisni për artin në periudhën e Barokut. Përmendni dhe komentoni krijimtarinë e dy artistëve të kësaj periudhe.**
- b. Flisni për veprën *Dea e Butrintit*. Ku u zbulua ajo dhe çfarë paraqet?**
- c. Çfarë kuptoni me termin "*Land Art*". Përmendni një artist të kësaj rryme dhe një punë të tij.**

Teza 4

- a. **Flisni për piktorin Van Gogh.** Shpjegoni kohën kur ai jetoi dhe komentoni një nga veprat e tij.
- b. **Flisni mbi një *fotograf të njohur bashkëkohor shqiptar*.** Teknika dhe stili i tij artistik.
- c. **Çfarë është video-instalacioni?** Përmendi një autor që përdor këtë medium në artin shqiptar.

Teza 5

- a. **Flisni për Post impresionizmin dhe disa nga emrat kryesorë të kësaj rryme artistike.** *Përmendni disa nga veprat e tyre dhe komentoni ato.*
- b. **Kush ishte Onufri?** Kur jetoi ai dhe çfarë tiparesh ka krijmtaria e tij?
- c. **Flisni për një ekspozitë të artit bashkohor.** Shpjegoni veprat dhe teknikat që përdorin artistët në të.

Teza 6

- a. **Kohëzgjatja dhe tipare të *Rilindjes Italiane*.** Përmendni dhe komentoni dy vepra nga arti i kësaj periudhe.
- b. **Kur u implemnetuar metoda e "*Realizmi Socialist*" në Shqipëri.** Cilat ishin tiparet kryesore të kësaj rryme. Komentoni një vepër tipike të Realizmit Socialist Shqiptar.
- c. **Shpjegoni termin "*Instalacion*".** Përmendni dhe trajtoni dy punë të kësaj forme artistike.

Teza 7

- a. Kush ishte Konstantin Brancusi. Shpjegoni tiparet e krijimtarisë së këtij artisti.
- b. Flisni mbi *ardhjen dhe zhvillimin e fotografisë në Shqipëri*.
- c. Çfarë kuptoni me termin “*Multimedia*”?

Teza 8

- a. Kush ishte *Marsel Duchamp*. Cila është koha kur ai jetoi dhe pse ishte e rëndësishme krijimtaria e tij?
- b. Flisni mbi jetën dhe veprën e *Kol Idromenos*. Analizoni e komentoni pikturën e tij “*Motra Tone*”.
- c. Shpjegoni rrymën artistike “*Dada*”. Kushtet historike gjatë së cilës u zhvillua kjo rrymë dhe veprat e tyre.

Teza 9

- a. Citoni disa rryma artistike të shek. XX. Shpjegoni me gjerë njerën prej tyre si dhe dy vepra nga rryma e zgjedhur.
- b. Çfarë dini rreth fotografit *Gjon Mili*? Ku u zhvillua vepra e tij dhe çfarë risish kishte ajo për kohën?
- c. Citoni një artist bashkëkohor të famshëm sot në botë dhe shpjegoni stilin e punës së tij.

Teza 10

- a. **Kush është autori i „Darkës së Fundit“.** Tipare të kësaj vepre dhe karakteristikat e kohës kur ai jetoi.
- b. **Citoni disa vepra të skulptorit *Odhise Paskali* dhe analizoni njerën prej tyre.**
- c. **Çfarë kuptoni me termin *Performancë*.** Flisni më tepër mbi një artiste apo artist që punon në këtë formë.

Teza 11

- a. **Flisni për piktorin e njohur *Pablo Picasso*.** Komentoni një vepër nga ky artist.
- b. **Citoni disa vepra të piktorit *Vilson Kilica* dhe analizoni njerën prej tyre.**
- c. **Flisni për një artist bashkohor shqipar të famshëm sot në arenën ndërkombëtare.** Citoni një vepër të tij.

Teza 12

- a. **Kush është autori i veprës *“Las Meninas”*.** Shpjegoni pse kjo vepër konsiderohet një nga veprat më të rëndësishme të artit botëror.
- b. **Citoni tre vepra të piktorit *Vangjush Mio* dhe analizoni njerën prej tyre.**
- c. **Flisni për artistin *Joseph Kosuth*.** Kush është ai dhe për çfarë dallohet?

Teza 13

- a. *Kush është piktori Rembrand, kur jetoi dhe çfarë temash trajtoi ai.*
- b. *Citoni disa vepra të skulptorit *Janaq Paço* dhe analizoni njerën prej tyre.*
- c. *Çfarë është Bialja e Venecias dhe për çfarë është e rëndësishme ajo?*

Teza 14

- a. *Flisni për artistin *Jackson Pollock*. Komentoni stilin që identifikoi këtë artist.*
- b. *Flisni për skulptorin *Thoma Thomai* dhe analizoni njerën prej veprave të tij.*
- c. *Kush është *Marina Abramoviç*? Me çfarë mediumi shprehet ajo?*

Teza 15

- a. *Flisni për piktorin e njohur *Salvador Dali* . Komentoni një vepër nga ky artist.*
- b. *Cili ishte piktori *David Selenica* dhe cilës periudhë artstike i përket ai.*
- c. *Çfarë kuptoni me termin *Body Art*. Flisni më tepër mbi një artiste apo artist që punon në këtë formë.*

Bibliografi

- Ernst H. Gombrich, *Historia e Artit*, (1996).
- Ermir Hoxha, *Historia e Artit Shqiptar 1858- 2000*, (2019)
- Rozela Dhimgjini, *Momente të Historisë së Artit nga Rilindja deri në shek. XX*, (2016).
- **Internet:** List of art movements.

PYETJET PËR PROGRAMIN GRAFIKË:

Teza 1

- a. Flisni për Artin e Grafikës në Artin Botëror, kush janë disa nga artistët përfaqësues të këtij mediumi.
- b. Flisni mbi piktorin shqiptarë pasbizantin Onufri. Çfarë e bën të rëndësishme veprën e këtij krijuesi?
- c. Cilat janë *Teknikat e Gravurës*. Përmendni dhe shpjegoni disa prej tyre.

Teza 2

- a. Flisni për Albert Durer dhe krijimtarinë e tij në gravurë. Komentoni veprën e tij *Melankolia*.
- b. Cilët janë fotografët *Marubi*. Vlera e punës së tyre dhe kohën kur ato jetuan.
- c. Flisni për *artin e Posterit* në fund të shek. 19-të. Trajtoni një artist të këtij stili dhe shpjegoni teknikën e tij (Toulouse-Lautrec; Mucha etj.).

Teza 3

- a. Flisni për piktorin Leonadro Da Vinci dhe tiparet e artit të tij. Përmendni dhe komentoni dy vepra nga krijimtaria e tij.
- b. Flisni për *Amfiteatrin e Butrintit*. Periudha e ndërtimit dhe për çfarë shërbente?
- c. Çfarë është *Dizajni Grafik*. Vlerat dhe përdorimi i tij.

Teza 4

- a. **Flisni për piktorin Caraviaggio.** Flisni për kohën kur ai jetoi dhe komentoni dy vepra nga krijimtaria e tij.
- b. **Flisni mbi një artist të njohur bashkëkohor shqiptar.** Teknika dhe stili i tij artistik.
- c. **Flisni për teknikën e Ksilografisë, Linografisë dhe teknika e gjilpërës së thatë.** Shpjegoni më gjatë si realizohen ato.

Teza 5

- a. **Flisni për artisti italian Mikelanxhelo.** Periudha kohore dhe tiparet kryesore të krijimtarisë së tij. Përmendni dhe komentoni dy vepra nga ky autor.
- b. **Çfarë është “Kodiku I Purpurt I Beratit”.** Përmendni përse shërbejnë ato dhe ç’rëndësi kanë për ne.
- c. **Flisni për rëndësinë e Gravurës në artin mesjtar.** Flisni mbi teknikën dhe vlera e tyre, të shpjeguara në bazë të një shembulli.

Teza 6

- a. **Kohëzgjatja dhe tipare të Rilindjes Italiane.** Përmendni dhe komentoni dy vepra nga arti i kësaj periudhe.
- b. **Kur u implementuar metoda e “Realizmit Socialist” në Shqipëri.** Tipare të kësaj rryme. Komentoni një vepër tipike të Realizmit Socialist Shqiptar.
- c. **Kush ishte Presa e parë e shtypit dhe shpikësi i saj.** Libri i parë i shtypur. Vlerat e kësaj teknologjie.

Teza 7

- a. Kush ishte “*Andy Warhol*. Flisni për këtë artist, stilin e punëve të tij dhe konceptin e ri artistik që ai sjell.
- b. Flisni mbi ardhjen dhe zhvillimin e *fotografisë në Shqipëri*.
- c. *Flisni për një ekspozitë grafike që keni parë*. Shpjegoni teknikat që pate aty dhe komentoni gjuhën artistike të tyre.

Teza 8

- a. *Flisni për skulptorin August Rodin. Kur jetoi ai dhe cila ishte rëndësia e krijimtarisë së tij?*
- b. Flisni mbi jetën dhe veprën e *Kol Idromenos*. Analizoni e komentoni pikturën e tij “*Motra Tone*”.
- c. *Artistë shqiptarë bashkëkohorë që punojnë në formën e “Dizajnit Grafik”*. Mediat që përdorin dhe punë të tyre.

Teza 9

- a. Citoni rryma dhe *stile artistike të shek. XX*. Shpjegoni më gjerë njerën prej tyre si dhe dy vepra nga rryma e zgjedhur.
- b. Çfarë dini rreth piktorit David Selenica? Ku u zhvillua vepra e tij dhe çfarë karakteristikash kishte ajo?
- c. Citoni disa nga teknikat e grafikës. Shpjegoni më gjatë procesin e realizmit të njërës njërën prej tyre.

Teza 10

- a. Kush ishte piktori Klod Monet. Flisni për kohën kur ai jetoi dhe komentoni disa nga verat e tij.
- b. Citoni tre vepra të skulptorit *Odhise Paskali* dhe analizoni njerën prej tyre.
- c. Cila ishte *Käthe Kollëitz*. Flisni mbi këtë artiste dhe komentoni dy vepra të saj.

Teza 11

- a. Flisni për piktorin e njohur *Pablo Picasso*. Komentoni një vepër nga ky artist.
- b. Citoni disa vepra të piktorit *Vilson Kilica* dhe analizoni njerën prej tyre.
- c. Flisni për gdhëndjes në *Linoneum*. Si realizohet ajo dhe çfarë synon?

Teza 12

- a. Kush është autori i veprës *“Las Meninas”*. Shpjegoni pse kjo vepër konsiderohet një nga veprat më të rëndësishme të artit botëror.
- b. Citoni tre vepra të piktorit *Vangjush Mio* dhe analizoni njerën prej tyre.
- c. Flisni për gravurat e *Emil Nolde*. Kush është ai dhe për çfarë dallohet?

Teza 13

- a. Kush është piktori *Rembrand*, kur jetoi dhe çfarë temash trajtoi ai.
- b. Citoni disa vepra të grafistit *Pandi Mele* dhe analizoni njerën prej tyre.
- c. Çfarë është *Bienalja e Venecias* dhe për çfarë është e rëndësishme ajo?

Teza 14

- a. Flisni për artistin Jackson Pollock. Komentoni stilin që identifikoi këtë artist.**
- b. Flisni për zhvillimin e grafikës në Shqipëri në kohën e komunizmit. Përmendni disa artistë dhe tiparet kryesore të krijimtarisë së tyre.**
- c. Kush është Marina Abramoviç? Me çfarë mediumi shprehet ajo?**

Teza 15

- a. Flisni për piktorin e njohur Salvador Dali. Komentoni një vepër nga ky artist.**
- b. Cili ishte piktori David Selenica dhe cilës periudhë artistike i përket ai.**
- c. Çfarë është teknika e gjilpërës së thatë. Flisni më gjatë për të dhe për një artist që përdor këtë teknikë.**

Bibliografi

- Ernst H. Gombrich, *Historia e Artit*, (1996).
- Ermir Hoxha, *Historia e Artit Shqiptar 1858- 2000*, (2019)
- Rozela Dhimgjini, *Momente të Historisë së Artit nga Rilindja deri në shek. XX*, (2016).
- **Internet:** List of art movements.